



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Adresa: Perandori Justinian, PN, Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 25 janar 2010
Ref.: Nr. RK-02/10

VENDIM

Rasti Nr. KI 02/09

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke vepruar nëpërmjet Kolegjit Shqyrtues në përbërje:

Z. Enver Hasani, Kryetar
Z. Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Znj. Iliriana Islami, Gjyqtar,

me procesmbajtësin, Z. Naser Hasani, Drejtor i Regjistrimit të Lëndëve, Statistikë dhe Arkivi në Sekretarinë e Gjykatës dhe Z. Robert Carolan, Gjyqtar Raportues, në mbledhjen e 24 nëntorit 2009 shqyrtoi kërkesën Nr. KI 02/09, ku:

Parashtruesi i Kërkesës është:

Z. Kolë Krasniqi
Fshati Meqë, Gjakova
Tel: 044 409 903

dhe Palët Kundërshtare janë:

Ministria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Çështjeve Pronësore-Juridike dhe Rregullimin e tokës e Komunës së Gjakovës.

I. Subjekti i çështjes

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, Nr. 2324 të datës 22 shtator 2009, Ref. S.P. 418/08 dërguar në Drejtorinë e Çështjeve pronësore-juridike të Komunës së Gjakovës në lidhje me rikthimin e patundshmërisë e cila është marrë për themelimin e fondit të tokës bujqësore në Gjakovë me Vendimin e datës 9 nëntor 1953. Ky Vendim mori nga paraardhësi i tij ligjor ngastrat, pjesën e ngastrës kadastrale Nr. 3/2, tokë bujqësore të kategorisë së III-të, me sipërfaqe prej 2.5 hektarë, 3/2 livadhe me sipërfaqe prej 0.55 hektarë dhe ngastrën me Nr. 92 tokë bujqësore me sipërfaqe 1.2552 hektarë me gjithsej 4.52 hektarë.

Ligji mbi Shpronësimin i Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 22/53) ka qenë i zbatueshëm për rikthimin e pronave private në një kohë kur parashtruesi i kërkesës, Kolë Krasniqi, filloi aplikimin e tij për rikthimin e

patundshmërisë. Sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/59, që amendamento i Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24, Ligj i zbatueshëm në Kosovë derisa Kosova u shpall republikë e pavarur ka qenë ende ligj në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989

Fillimisht më 15 janar 1992, Kërkuesi, Kolë Krasniqi, e drejtoi kërkesën e tij për rikthim të pronës në Drejtorinë e Çështjeve Pronësore-Juridike-dhe Rregullimin e tokës në Komunën e Gjakovës. Kërkesa e tij nuk u përfundua plotësisht. Kolë Krasniqi pohon se ka pasur arsye të shumta përse kërkesa e tij nuk u përfundua kurrë: 1) disa lider komunalë kërkonin nga ai para për ryshfet, 2) liderët e tjerë komunalë e zvarritnin dhe pengonin përpjekjet e tij që të përfundonte kërkesën e parashtruar sepse ligji përkatës në atë kohë ishte ligji Serb. Kolë Krasniqi nuk e përfundoi dot kërkesën e sipërpërmendur deri në bombardimet e NATO-s të datës 24 mars 1999.

Më 20 nëntor 2008, me Vendimin Nr. 19-463-8/91-08, Drejtoria refuzoi kërkesën e tij për rikthim të patundshmërisë duke e përmbyllur se nuk ka baza ligjore për rikthim të patundshmërisë sepse Republika e Kosovës, si një shtet i pavarur dhe sovran nuk posedon asnjë ligj që autorizon rikthimin e patundshmërisë tek ish-pronarët e tokave shtetërore.

Më 9 shkurt 2009, kërkuesi Kolë Krasniqi paraqiti një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës duke u ankuar se Kushtetuta është shkelur me Vendimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

II. Pohimet e Kërkuesit

Kërkuesi pohon se Vendimi Nr. 2324 i datës 22 shtator 2008 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, shkel Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse:

- 1) Ministria e ka autoritetin ligjor të imponojë ligjin e zbatueshëm të ish-Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë;
- 2) Moskryerja e imponimit të këtij ligji tashmë është diskriminuese kundrejt tij në shkeljen e Kushtetutës.

III. Përgjigjja e Palës kundërshtare ose e Palëve të tjera të interesuara

As Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe as Drejtoria e Çështjeve Pronësore–Juridike dhe e Rregullimit të tokave në Komunën e Gjakovës nuk paraqitën përgjigje zyrtare.

Vlerësimi i Pranueshmërisë së Kërkesës

Neni 46 i **Kushtetutës** siguron:

- 1." E drejta e pronës është e garantuar".

3. "Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet".
4. "Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente".

Neni 143 i **Kushtetutës** siguron:

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

1. "Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.
3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë".

Neni 2 i Aneksit VII i Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, me datë 26 mars 2007 deklaron se administrimi i ndërmarrjeve shoqërore (NSH) dhe aseteve të tyre do të ushtrohet nga institucioni i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) ashtu siç është paraparë në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut 2001/12.

Neni 3 i Aneksit VII i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i datës 26 mars 2007 deklaron se caktimi përfundimtar i pronësisë dhe shqyrtimi i kërkesave do të vazhdojë të bëhet nga Dhoma e Posaçme në Gjykatën Supreme, e themeluar për këtë qëllim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13.

Neni 4 i Aneksit VII i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i datës 26 mars 2007 sugjeron se shqyrtimi i rasteve pronësore do të përfundohet jo më vonë se data 31 dhjetor 2008.

Neni 5 i Aneksit VII i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i datës 26 mars 2007 deklaron se posedimi i paligjshëm i pasurisë së paluajtshme private nuk jep të drejta pronësore. Nëse parashtruesi i ankesës mund të vërtetojë se nuk ka pasur qasje në institucionet relevante për dorëzimin e një ankese sipas

afatit të paraparë, në mënyrë që ajo të trajtohet në kuadër të afatit të paraparë, ankesa e tillë nuk do të konsiderohet se nuk është pranuar nga gjykata kompetente ose nga organi tjetër gjyqësor ose gjoja gjyqësor. Ky Nen gjithashtu shton se Kosova do të zbatojë masa shtesë për të siguruar, në bashkëpunim me ICR, se procesi i shqyrtimit të kthimit/kompensimit të kërkesave pronësore të jetë efikas dhe vendimet të zbatohen në mënyrë efektive.

Neni 6 i Aneksit VII i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i datës 26 mars 2007 deklaron se Kosova do të trajtojë çështjet e kthimit të pronës si çështje me rëndësi të veçantë dhe përcakton krijimin e mekanizmave të pavarur për të formuluar politikat, kornizën ligjore dhe atë institucionale për trajtimin e çështjeve të kthimit të pronës.

Neni 24 i Kushtetutës siguron:

1. "Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim".
2. "Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal".
3. "Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato".

Parashtuesi i kërkesës, Kolë Krasniqi duket që mbështetet në dispozitat e lartpërmendura të **Kushtetutës** me qëllim të mbështetjes së Kërkesës së tij, edhe pse ai nuk përcakton në mënyrë specifike se cilat dispozita të **Kushtetutës** përkrahin rastin e tij konkret.

Paragrafi 7 i Nenit 113 të **Kushtetutës** siguron se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Paragrafi 2 i Nenit 47 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës siguron si vijon:

"Individi mund të paraqesë Kërkesë-Referimin për rastin konkret vetëm pasi që të ketë shterur të gjitha mjetet juridike, siç parashihen me Ligj".

Neni 48 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës siguron se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Në këtë rast, nuk duket se parashtruesi i kërkesës ka shterur të gjitha mjetet juridike, siç parashihen me ligj. Mesa duket ai duhet të paraqesë fillimisht kërkesën e tij në Dhomën e Posaçme të Gjykatës, themeluar nga Gjykata Supreme e Kosovës ose në ndonjë gjykatë tjetër kompetente të posaçme e cila kërkon që të shqyrtohen kërkesat e kthimit të pronës së paluajtshme, siç parashtrohet në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Në këtë rast, ankuesi nuk ka vërtetuar se ai gëzon autoritetin ligjor që të bëjë një kërkesë për rikthimin e pronës së paluajtshme, në fjalë. Ai pohon se prona në fjalë është shpronësuar nga një person tjetër sesa nga autoritet shtetëror në pushtet para shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe me pushtet sovran. Ai nuk ka përcaktuar se çfarë të drejta të pronës së paluajtshme, nëse ka të tillë, ka marrë prej atij personi. Ai gjithashtu nuk ka përcaktuar se në cilin autoritet ai duhet të paraqesë kërkesë në emër të atij personi për të cilin pretendon se e ka pronën e tij të paluajtshme të shpronësuar në mënyrë të paligjshme.

Kështu që, në këtë moment, **Kërkesa e parashtruesit nuk është e pranueshme.** Kërkesa e tij mund të konsiderohet më pas si e pranueshme nëse: (1) ai vërteton që gëzon të drejta të njëjta ligjore të kësaj prone si edhe personi i cilit aktualisht e ka shpronësuar këtë pronë nga ai me autoritetin shtetëror në kohën e shpronësimit; dhe se (2) ai vërteton se ka shterur të gjitha mjetet juridike nëpërmjet gjykatës kompetente në Kosovë ose autoritetit të posaçëm gjyqësor për shqyrtimin e kërkesave të tilla siç parashihet në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Vlerësimi i aspekteve ligjore thelbësore të kërkesës

Nëse parashtruesi i kërkesës vërteton se ai ka paraqitur kërkesë të ligjshme për rikthimin e pronës ose kompensim adekuat për pronën e paluajtshme që ai pohon se i është shpronësuar në mënyrë të paligjshme, atëherë kërkesa e tij mund të lejohet në të ardhmen. Por kjo gjykatë nuk do të spekulojë mbi lejueshmërinë e kërkesave të ardhshme.

Nëse kërkesa e parashtruesit nuk është shqyrtuar asnjëherë nga ndonjë organ i posaçëm gjyqësor në Kosovë, atëherë të drejtat e tij mund të jenë shkelur sipas *Nenit 46 dhe 143 të Kushtetutës*, sepse atij i është privuar arbitrarisht e drejta e pronës pa kompensim të menjëhershëm dhe adekuat, e kështu që i është mohuar e drejta e zotërimit të pronës nga autoriteti publik. Por kjo Gjykatë nuk mund të spekulojë mbi pranueshmërinë e ndonjë kërkesë të ardhshme në këtë rast, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka vërtetuar që ka një kërkesë të ligjshme për pronën e paluajtshme në kundërshtim dhe nuk ka shterur mjetet e tij juridike sipas *Nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës dhe Nenin 47 të Ligjit Mbi Gjykatën Kushtetuese*.

PËR KËTO ARSYE, VENDOS SI VIJON:

- I. Kërkesa për rikthimin e pronës së paluajtshme, siç parashtrohet në Kërkesë shpallet e papranueshme.
- II. Parashtruesi i kërkesës, Kolë Krasniqi, Palët Kundërshtare, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Çështjeve Pronësore–Juridike dhe Rregullimit të tokave në Komunën e Gjakovës do të njoftohen për këtë vendim. Për arsye informative, edhe Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme Të Kosovës do të njoftohet.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert Carolan, d.v.
Gjyqtar Raportues



Enver Hasani, d.v.
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese